



Lidhja Demokratike e Kosovës

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2013 - 31 Dhjetor 2013

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.. .. .	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-17

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se Lidhjes Demokratike te Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “LDK”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2013, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-17.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2013, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 ,Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç paraqitet në shënimin 9 të pasqyrave financiare, Shpenzimet, subjekti politik ka Pagat dhe kompensimet ne vlerë 255,862.62 EUR, ne mungese te dokumenteve mbështetëse, kontratave te punës, vendimet etj, ne duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit nuk ishim ne gjendje të përfitojmë një siguri të arsyeshme në lidhje me plotësinë e kësaj shume për periudhën e përfunduar më 31 dhjetor 2013

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 EUR brenda një dite ne kundërshtim me kërkesat ligjore të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, neni 26 Detyrimet shtesë të partive politike.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- Gjatë auditimit tone ne kemi vërejtur që të shpenzimet e reprezentacionit dhe karburantit , ne disa raste SP nuk ka dokumentacion relevant mbështetës, përveç faturave, që do munde të arsyetonin dhe mbështetnin shpenzimin e ndodhur.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të

likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.



Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Elmije Osmani
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	106,893.05	12,474.05
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		106,893.05	12,474.05
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	3	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	164,834.40	564,397.35
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		164,834.40	564,397.35
Total pasuritë		271,727.45	576,871.40
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		549,536.76	103,332.28
Suficiti / (deficiti) i vitit		(437,804.23)	446,204.48
Total Ekuiteti		111,732.53	549,536.76
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huat e pagueshme			
Të hyrat e shtyra		106,893.05	12,474.05
Gjithsej detyrimet afatgjata		106,893.05	12,474.05
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	5	15,140.25	9,400.78
Detyrimet tjera afatshkurtra	6	37,961.62	5,459.81
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		53,101.87	14,860.59
Gjithsej detyrimet		159,994.92	27,334.64
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		271,727.45	576,871.40

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2013	2012
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		803,787.00	890,034.20
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	7	0.00	1,090.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	8	1,800.00	5,674.80
Të hyrat e fushatës		25,030.00	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyra	2	9,044.00	
Të hyrat tjera		15,555.84	
Gjithsej të hyrat për vitin		855,216.84	896,799.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	9	255,862.62	229,245.58
Shpenzimet e transportit	9	56,523.31	35,010.92
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	9	113,417.35	61,133.90
Shpenzimet e fushatës	9	768,691.76	54,532.94
Blerja e mallrave	9	21,070.20	12,620.71
Shpenzimet e përgjithshme	9	59,616.48	34,238.22
Shpenzimet e ndryshme	9	17,839.35	23,812.25
Gjithsej shpenzimet për vitin		1,293,021.07	450,594.52
Suficiti / (deficiti) për vitin		(437,804.23)	446,204.48

1. Informata te përgjithshme

Lidhja Demokratike e Kosovës është partia e tretë më e madhe në Kosovë. Është një parti konservatore dhe liberale konservatore

Udhëheqja: Isa Mustafa (Kryetar i partisë)

Themelues: Ibrahim Rugova

Themeluar: 23 dhjetor 1989

Ideologjia: konservatizmi, neoliberalizmi, liberalizmi i tregut.

Pozita politike: Politika e qendrës së djathtë

Pasqyrat financiare te Lidhjes Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën NLB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////		0.00
Objektet					
Veturat		90,440.00		9,044.00	81,396.00
Pajisjet e zyrës	4,165.25	1,478.00			5,643.25
Pajisjet e teknologjisë informative	6,988.80	11,545.00			18,533.80
Pajisjet tjera	1,320.00				1,320.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	12,474.05	103,463.00	0.00	9,044.00	106,893.05

Shënimi 3. Llogaritë e arkëtueshme

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Llogaritë e arkëtueshme vendore	-	-
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	-	-

Shënimi 4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Paraja në bankë	164,834.40	564,397.35
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	164,834.40	564,397.35

Shënimi 5. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Furnitor vendor	15,140.25	9,400.78
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	15,140.25	9,400.78

Shënimi 6. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	5,612.82	2,419.31
Detyrimet për qira	398.80	40.50
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	31,950.00	3,000.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	37,961.62	5,459.81

Shënimi 7: Donacionet dhe kontributet në të holla

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka pranuar donacione dhe kontribute në të holla gjatë vitit 2013.

Shënimi 8: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuuesi	Adresa	Numri personal		
Qiraja e Zyrave	Ismet Gashi	Prishtinë rr e Shkodres -13	1019463415	02.01.2013	1,800.00
Veture Jeep Liberty	Nura Group	Prishtinë rr Bill Clinton pn	600637469	22.08.2013	9,500.00
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					11,300.00

Shënimi 9: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	222,738.87	222,738.87	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	11,500.27	10,543.12	957.15
Kontributet pensionale të punëdhënësit	11,500.27	10,543.12	957.15
Tatimet në të ardhura personale	10,123.21	9,263.80	859.41
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	255,862.62	253,088.91	2,773.71

Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	32,137.52	29,510.19	2,627.33
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.	13,431.30	13,431.30	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	9,254.49	9,254.49	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	1,700.00	1,510.00	190.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	56,523.31	53,705.98	2,817.33
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	24,976.15	24,976.15	0.00
Ushqimi	40,962.93	40,294.93	668.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	7,012.70	7,012.70	0.00
Radio dhe spotet televizive	2,000.00	2,000.00	0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	1,411.36	1,411.36	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	37,054.21	36,884.59	169.62
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	113,417.35	112,579.73	837.62
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	768,691.76	730,526.25	38,165.51
Gjithsej shpenzimet e fushatës	768,691.76	730,526.25	38,165.51

Lidhja Demokratike e Kosovës

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor, 2013

Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	20,495.20	20,495.20	0.00
Pajisjet të vogla	575.00	575.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	21,070.20	21,070.20	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	25,405.05	25,006.25	398.80
Telefoni, interneti dhe posta	14,826.84	12,614.84	2,212.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	8,540.59	7,184.35	1,356.24
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	9,044.00	//////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	1,800.00	//////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	59,616.48	44,805.44	3,967.04
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	6,722.24	6,662.24	60.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	11,117.11	11,116.60	0.51
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	17,839.35	17,778.84	60.51
Gjithsej shpenzimet	1,293,021.07	1,233,555.35	48,621.72

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:				Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal	Data kur është bërë pagesa	
Ushqim	Agi	Banull-Lipjan	600185450	15.08.2013	5,000.00
Stenda afishimi	AMM	L. Haradinaj-Prishtinë	600151336	11.10.2013	9,947.00
Vendimi nr- 419/07 C.nr.	Atelie Guri(Albert Bakiu)	Prishtinë	1004342182	15.05.2013	7,340.00
Vetura	Autoteknik-Baholli	Prishtinë	600149703	Specifikacioni	81,311.76
Shpenzime tjera te reklamave	Blendi	Prishtinë	600178405	Specifikacioni	5,522.94
Ushqim	Bodensee	Ahmet Kaçiku -Ferizaj	600313994	06.12.2013	9,540.00
Pajisje TI	Botek	Prishtinë	600151328	Specifikacioni	10,890.00
Spote televizive	Butterfy	Prishtinë	600368410	Specifikacioni	26,100.00
Material për Zyre	Comel	Prishtinë	600269379	21.08.2013	7,500.00
Ushqim	Dukagjini	Pejë	600249420	Specifikacioni	11,050.00
Stenda afishimi	Euro Printi	Prishtinë	600163860	Specifikacioni	8,035.00

Lidhja Demokratike e Kosovës

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor, 2013

Bileta aeroplani	Euro Koha	Prishtinë	600108353	Specifikacioni	9,101.00
Derivate	Faoni-AU	Fatoni	600075346	Specifikacioni	6,500.00
Shërbime artistike	Iliada Entertainment	Rte De la plage 44A.Le Bouveret.CH		Specifikacioni	6,560.00
Shpenzime tjera te reklamave	Intergraf	Kemajl Hetemi pn-Ferizaj	600089595	Specifikacioni	5,373.60
Shpenzime tjera te reklamave	KD Events	Fehmi Agani 29/A Prishtinë	600602173	Specifikacioni	194,089.82
Rryma	Kedc	Prishtinë	600678471	Specifikacioni	7,550.09
Spote televizive	Klan Kosova	QT Bregu I diellit Prishtinë	600359378	Specifikacioni	80,562.00
Spote televizive	KTV	Sheshi Nëna Terezë Prishtinë	600157722	Specifikacioni	36,484.00
Ushqim	Laza	Gjilan	600249339	Specifikacioni	6,412.00
Karburante dhe ushqim	Mani	Malishevë	600069472	Specifikacioni	9,400.61
Shpenzime tjera te reklamave	Mega Music	Prishtinë	600289012	19.11.2013	5,260.00
Material për Zyre	Micro	Prishtinë	600085080	Specifikacioni	8,247.10
Hapësira me qira	NPB Prishtina	Sheshi Bill Klinton Prishtinë	600390033	Specifikacioni	9,706.50
Karburante	Petroll Oti Sllovenija	Magjistranja Pr-Mitrovicë	600112370	Specifikacioni	26,724.07
Stenda afishimi	Printing Center	Ali Kelmendi Ferizaj	601018923	Specifikacioni	5,016.60
stenda afishimi	Rama Print	Rahovec	600077350	Specifikacioni	8,782.20

Lidhja Demokratike e Kosovës*Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor, 2013*

stenda afishimi	RTK	Sheshi Nëna Terezë Prishtinë	600294657	Specifikacioni	34,844.00
stenda afishimi	RTV-21	Pallati i Mediave-Prishtinë	600085361	06.11.2013	19,121.00
stenda afishimi	Svinga	Xhemë Gostivari-Prizren	600035324	29.10.2013	6,820.00
Telefonia fikse	Telekomi i Kosovës	Prishtinë	600016762	Specifikacioni	5,197.38
Ushqim	Univers	Vermicë-Prizren	600033667	Specifikacioni	14,458.00
Shpenzime tjera te reklamave	Vertigo	Prizren	80235305	29.10.2013	5,875.00
Stenda afishimi	you Name it	Prishtinë	600043137	08.10.2013	5,069.20
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					699,390.87